

Fondi i Pensionit Privat “Sigal Pro”

**Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025**

Përmbajtja

Raporti i Audituesit të Pavarur	i
Pasqyra financiare	
Pasqyra e aktiveve neto të disponueshme për përfitime	1
Pasqyra e veprimtarisë	2
Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto të disponueshme për përfitime	3
Pasqyra e flukseve monetare	4
1. Informacion i përgjithshëm	5
2. Politika të rëndësishme kontabël	6
2.1. Baza e përgatitjes	6
2.2. Terminologji kryesore	6
2.3. Vlera Neto e Aktiveve (NAV)	6
2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes	6
2.5. Transaksionet në valutë të huaj	6
2.6. Subjekti investues dhe konsolidimi	6
2.7. Aktivet financiare dhe detyrimet financiare	7
2.7.1. Njohja dhe matja fillestare	7
2.7.2. Klasifikimi dhe matja mëpasshme	7
2.8. Matjet e vlerës së drejtë	8
2.9. Mjete monetare	8
2.10. Shpenzimet operative	8
3. Menaxhimi i rrezikut financiar	8
3.1. Kuadri i menaxhimit të rrezikut	9
3.2. Depozitari	9
3.3. Politika e investimeve	9
3.4. Rreziku i tregut	10
3.4.1. Rreziku i valutës së huaj	10
3.4.2. Rreziku i normës së interesit	10
3.5. Rreziku i likuiditetit	11
3.6. Rreziku kreditor	11
3.7. Testimi i zhvlerësimit të aktiveve financiare	12
3.8. Rreziku operacional	12
4. Paraqitja me vlerë të drejtë	12
5. Mjete monetare	13
6. Investime në letra me vlerë	13
7. Detyrimet ndaj Shoqërisë së Administrimit	13
8. Të ardhurat nga interesi	14
9. Shpenzimet e tarifës së administrimit	14
10. Angazhime dhe detyrime të konstatuara	14
11. Transaksionet me palët e lidhura	14



Raporti i Audituesit të Pavarur

Drejtuar Këshillit të Administrimit të Fondit të Pensionit Privat “Sigal Pro”:

Opinionin ynë

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Fondit të Pensionit Privat “Sigal Pro” (“Fondi”) janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me politikat kontabël të specifikuar në shënimin shpjegues 2 të pasqyrave financiare.

Ne kemi audituar

Pasqyrat financiare të fondit përfshijnë:

- pasqyrën e aktiveve neto të disponueshme për përfitime më 31 dhjetor 2025;
- pasqyrën e veprimtarisë për vitin e mbyllur më atë datë;
- pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto të disponueshme për përfitime për vitin e mbyllur më atë datë;
- pasqyrë e flukseve monetare për vitin e mbyllur më atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë politika të rëndësishme të kontabilitetit dhe informacione të tjera shpjeguese.

Baza për opinionin

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të këtij raporti.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të bazuar opinionin tonë.

Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga fondit në përputhje me kërkesat etike të Ligjit “Për auditimin ligjor dhe profesionin e audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (Ligji për Auditimin Ligjor) që janë të

PricewaterhouseCoopers Assurance Services SH.P.K.
Rruga Ibrahim Rugova, Sky Tower 9/1, Tiranë, Shqipëri
T: +355 (4) 2242 254

www.pwc.com/al

Regjistruar me Qendrën Kombëtare të Biznesit me Numër Unik të Identifikimit të Subjektit NUIS/NIPT: L92014010J
Regjistruar në Regjistrin Publik të Audituesve Ligjorë me Vendim nr. 701, 03.07.2020 të Komitetit të Regjistrimit

zbatueshme për auditimet e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Etikës) të publikuara nga Bordi Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (Kodi BSNEK) që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare për njësitë ekonomike me interes publik. Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me Ligjin për Auditimin Ligjor dhe kodin e BSNEK-së.

Përgjegjësitë e drejtuesve dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare

Drejtuesit janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me shënimin shpjegues 2 të pasqyrave financiare, dhe për kontrollet e brendshme, të cilat ata i gjykojnë të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo pasaktësisë.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtuesit janë përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e fondit për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vendosur në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e veprimtarisë, nëse është rasti, përveç atyre rrethanave kur drejtuesit synojnë që fondi të likuidohet apo të ndërpresë veprimtarinë, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç këtyre.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të fondit.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të fitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi, nuk përmbajnë anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por ajo nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një anomali materiale.

Anomali të mund të vijnë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të kenë ndikim në vendimet ekonomike të marra nga përdoruesit në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional përgjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalisë materiale në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një anomali materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një anomali si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.

- Sigurojmë kuptueshmëri të kontrolleve të brendshme që mund të jenë të nevojshme për hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efikasitetin e kontrolleve të brendshme të fondit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe të shënimeve shpjeguese të përgatitura nga drejtuesit.
- Arrijmë në një përfundim në lidhje me përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga drejtuesit dhe, bazuar në evidencën e siguruar nga procesi i auditimit, nëse ka një pasiguri domethënëse në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e fondit për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri domethënëse, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimet shpjeguese përkatëse të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimet shpjeguese përkatëse nuk janë të përshtatshme, të përfshijmë një rezervë në opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e mbledhur gjatë procesit të auditimit deri në datën e këtij raporti. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte të ardhshme mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së fondit.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrolleve të brendshme që konstatojmë gjatë procesit të auditimit.

Auditues Ligjor

Jonid Lamllari



Tiranë, Shqipëri

30 prill 2026

Fondi i Pensionit Privat "Sigal Pro"

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveçse nëse përcaktohet ndryshe)

Pasqyra e aktiveve neto të disponueshme për përfitime

	Shënimi	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	5	4,769,946	414,735
Investime në letra me vlerë	6	70,373,919	19,845,930
TOTALI I AKTIVEVE		75,143,865	20,260,665
DETYRIME			
Detyrime afatshkurtra			
Detyrime ndaj Shoqërisë së Administrimit	7	90,763	21,483
DETYRIMET (me përjashtim të aktiveve neto që i përkasin mbajtësve të kuotave)		90,763	21,483
MJETET NETO QË I PËRKASIN MBAJTËSVE TË KUOTAVE		75,053,101	20,239,182
Numri i kuotave		70,260.8426	19,780.7195
Vlera e aktiveve neto për kuotë		1,068.2070	1,023.1772

Pasqyrat financiare të Fondi i Pensionit Privat "SIGAL PRO" janë miratuar nga "Sigal Invest" Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SH.A., si Shoqëria Administruese e saj më 30 prill 2026, dhe nënshkruar në emër të saj nga:

Elvis Ponari
Administrator

Junida Ramku
Drejtoresh e Financës



Fondi i Pensionit Privat “Sigal Pro”*(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveçse nëse përcaktohet ndryshe)*

Pasqyra e veprimtarisë

	Shënimi	2025	2024
Të ardhura			
Të ardhurat nga interesi	8	2,673,915	250,100
Të ardhurat totale		2,673,915	250,100
Shpenzimet			
Shpenzimet e tarifës së administrimit	9	(688,317)	(89,715)
Shpenzimet totale operative		(688,317)	(89,715)
Rezultati operativ		1,985,598	160,385
Rritja e aktiveve neto që i përket mbajtësve të kuotave nga veprimtaria		1,985,598	160,385

Shënimet në faqet 5 deri në 14 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Fondi i Pensionit Privat "Sigal Pro"*(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveçse nëse përcaktohet ndryshe)*

Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto të disponueshme për përfitime

	2025	2024
Aktivitet neto që i përketin mbajtësve të kuotave më 1 janar	20,239,182	782,594
Shuma e kuotave të emetuara	53,539,169	19,326,399
Shlyerja e kuotave lidhur me largime	(710,847)	(30,196)
Rritje neto nga transaksionet e kuotave	52,828,322	19,296,203
Rritja e aktiveve neto që i përketin mbajtësve të kuotave nga operacionet	1,985,598	160,385
Më 31 dhjetor	75,053,102	20,239,182
Numri i kuotave në fillim të periudhës	19,780.7195	785.4216
Kuota të reja të emetuara nga kontributet	51,157.3167	19,025.2893
Kuotat lidhur me largimet	(677.2116)	(29.9914)
Numri i kuotave në fund të periudhës	70,260.8246	19,780.7195

Fondi i Pensionit Privat "SIGAL PRO"*(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveçse nëse përcaktohet ndryshe)*

Pasqyra e flukseve monetare

	2025	2024
Flukset monetare nga aktivitetet operative		
Rritje në shumën që i përkasin mbajtësve të kuotave	1,985,598	160,385
Rregullime për:		
Të ardhurat nga interesi	8 (2,673,915)	(250,100)
	(688,317)	(89,715)
Rritje e detyrimeve ndaj Shoqërisë Administruese	69,280	20,319
Interesi i marrë	945,926	17,733
Flukset monetare neto nga aktivitetet operative	326,889	(51,663)
Flukset monetare nga aktiviteti investues		
Blerje të letrave me vlerë	(48,800,000)	(19,613,563)
Flukset monetare neto përdorur në aktivitetin investues	(48,800,000)	(19,613,563)
Flukset monetare nga aktivitetet financuese		
Hyrjet e parave nga kontributet	53,539,169	19,326,399
Daljet monetare të paguara për mbajtësit e kuotave	(710,847)	(30,197)
Flukset monetare neto nga aktivitetet financuese	52,828,322	19,296,202
Rritje/(ulje) neto në mjete monetare	4,355,211	(369,024)
Mjete monetare në fillim të periudhës	414,735	783,759
Mjete monetare në fund të periudhës	5 4,769,946	414,735

Shënimet në faqet 5 deri në 14 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Fondi i Pensionit Privat "SIGAL PRO"

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(të gjitha shumatat janë të shprehura në lekë, përveç se kur përcaktohet ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

Fondi i Pensionit Privat "SIGAL PRO" ("Fondi") është një fond kontribut të përcaktuar i autorizuar me Vendim të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare ("AMF") nr. 251, datë 20 dhjetor 2022. Objektivi i Fondit është të gjenerojë rritje të afatmesme dhe afatgjatë të kapitalit të një portofoli letrash borxhi të emetuara nga Qeveria Shqiptare. Fondi është nën administrimin e "Sigal Uniqa Invest" Shoqëria e Administrimit të Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SH.A." ("Shoqëria Administruese") e cila është licencuar nga AMF më 30 mars 2011.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka miratuar Banka Kombëtare Tregtare SH.A. si kujdestar ("Depozitari") i Fondit. Shoqëria Administruese dhe Depozitari kërkohet të mbajnë aktivet, operacionet dhe të dhënat e Fondit të ndara nga aktivet, operacionet dhe të dhënat e veta.

Shoqëria Administruese e Fondit është me seli në Rrugën "Ukraina e Lirë", Ndërtesa Teknoprojekt, Tiranë, Shqipëri. Në këto pasqyra financiare, fjala "kuotë" ose "njësi kuote" i referohet njësisive të tërheqshme të Fondit. Fondi i ofron njësitë e tij çdo individ ose subjekti biznesi që ushtron veprimtarinë në Shqipëri ose jashtë saj, për t'i përdorur si një plan me kontribut të përcaktuar për punonjësit e tyre.

Strukturat e qeverisjes

Aksionarët e Shoqërisë Administruese kanë emëruar Këshillin e Administrimit të Fondit, i cili përbëhet nga pesë anëtarët e Këshillit të Mbikëqyrjes së Shoqërisë Administruese:

- Z.Adrian Totokoçi, Kryetar
- Z.Klement Mersini, Anëtar
- Z.Elvis Ponari, Anëtar
- Z.Abdyl Sarja, Anëtar
- Z.Edvin Hoxhaj, Anëtar

Depozitari

Shoqëria Administruese e Fondit ka marrëveshje depozitari me Bankën Kombëtare Tregtare SH.A.. Në përputhje me Ligjin nr. 76/2023, "Për fondet e pensioneve private", më poshtë "Ligji", Banka ofron shërbime të mirëbesimit, depozitarit për aktivet e fondit. Bankat që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë i nënshtrohen rregullimit nga Banka e Shqipërisë (Banka Qendrore) dhe licencohen nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) për të vepruar si ruajtës apo depozitarë të fondeve të përfitimeve pensionale.

Prospekti i Fondit

Shoqërisë Administruese i paguhet një tarifë vjetore prej 2.2% e cila llogaritet në bazë ditore ndaj Vlerës Neto të Aktiveve të Fondit shumëzuar me 2.2% / 365 si dhe një tarifë shtesë mujore të administrimit e cila llogaritet si 2.2% e tarifës vjetore të menaxhimit (llogaritur gjithashtu në baza ditore). Prej datës 22 korrik 2024, të dy tarifat zbritën në 1.5%.

Sipas ligjit, anëtarët e Fondit janë të ekspozuar ndaj rreziqeve që rrjedhin nga investimet e Fondit. Anëtarëve u kërkohet të paguajnë një penalitet nga 15% (vitet 1-5) deri në 2% (pas 20 vitesh kontribute) për tërheqjet para afatit.

2. Politika të rëndësishme kontabël

Politikat kryesore kontabël të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë shpalosur më poshtë. Këto politika janë zbatuar në mënyrë të qendrueshme për të gjitha periudhat e paraqitura, përveç rasteve kur shprehet ndryshe.

2.1. Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare të Fondit janë përgatitur në përputhje me kërkesat dhe udhëzimet e Rregullores nr. 104, datë 28 qershor 2024, të Bordit Drejtues të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare "Për mënyrën dhe afatin e përlllogaritjes së vlerës neto të aktiveve të fondit të pensionit privat, çmimit të kuotës, shndërrimin e kontributeve në kuota si dhe mënyrën e raportimit të informacionit", referuar si ("Rregullorja"). Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të kostos historike.

2.2. Terminologji kryesore

Vlera neto e aktiveve. Diferenca ndërmjet shumës totale të aktiveve të fondit dhe shumës totale të detyrimit të fondit ndaj palëve të treta.

Vlera neto e aktiveve për kuotë. Rezultati i pjesëtimit vlerës neto të aktiveve dhe numrit total të njësisve të kuotave.

Numri total i kuotave. Numri i kuotave të ditës së mëparshme plus kuotat e reja të emetuara për kontributet minus kuotat e transferuara në fonde të tjera.

Kuota të reja të emetuara. Shuma totale e kontributeve të bëra pjesëtuar me vlerën neto të aktiveve për kuotë nga fundi i ditës së mëparshme.

2.3. Vlera Neto e Aktiveve (NAV)

Aktivitet neto përfaqësojnë kontributet në para dhe kthimin nga investimi për këto kontribute pasi zbriten tarifat dhe komisionet për shoqërinë administruese që janë në pronësi të anëtarëve të fondit të pensionit të konvertuar në njësi kontabël. Çdo kuotë përfaqëson një pjesë proporcionale të pronësisë mbi aktivitet neto të Fondit. Njësitë e kuotave i referohen shumës totale të kontributit të pjesëtuar me vlerën e njësisë së kuotës. Çdo kontribut pasohet nga lëshimi i njësisë së kuotave siç përshkruhet më sipër duke qenë se fondi i pensionit privat është i hapur.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare paraqiten në lekë, që është monedha funksionale e Fondit, monedha e mjedisit kryesor ekonomik në të cilin është themeluar fondi.

2.5. Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valuta të huaja përkthehen në monedhën funksionale duke përdorur kurset e këmbimit të datave të transaksioneve. Aktivitet dhe detyrimet monetare të shprehura në valutë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit të datës së raportimit.

Zërat jo monetarë që maten bazuar në koston historike në valutë të huaj, përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat në valutë të huaj që lindin nga përkthimi njihen në fitim ose humbje.

2.6. Subjekti investues dhe konsolidimi

Fondi ka investitorë të shumtë të palidhur dhe mban shumë investime. Pasqyrat financiare të Fondit nuk janë të konsoliduara në pasqyrat financiare të shoqërisë administruese. Fondi është konsideruar se plotëson përkufizimin e një entiteti investues, aktivitet e te cilit janë të ndara nga shoqëria administruese dhe u përkasin vetëm mbajtësve të njësisve të kuotave.

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

2.7. Aktivet financiare dhe detyrimet financiare

2.7.1. Njohja dhe matja fillestare

Aktivitet dhe detyrimet financiare të Fondit maten fillimisht në datën e shlyerjes bazuar në vlerën e tyre të drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit, nëse ka. Vlera e drejtë në njohjen fillestare evidentohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Një fitim ose humbje nga njohja fillestare regjistrohet vetëm nëse ka një diferencë midis vlerës së drejtë dhe çmimit të transaksionit, i cili mund të evidentohet nga transaksione të tjera aktuale të vëzhgueshme të tregut në të njëjtin instrument ose nga një teknikë vlerësimi, inputet e së cilës përfshijnë vetëm të dhëna nga tregjet e vëzhgueshme.

2.7.2. Klasifikimi dhe matja mëpasshme

Fondi nuk ka investime në letra me vlerë të kapitalit. Letrat me vlerë të borxhit klasifikohen nga Këshilli i Administrimit dhe Komiteti i Investimeve të Shoqërisë Administruese si të mbajtura deri në maturim dhe maten me koston e amortizuar siç përcaktohet në nenin 21 të Rregullores së përmendur më sipër (Shënime 2.1). Në rast se synimi i Këshillit të Administrimit ose aftësia e Shoqërisë Administruese për të mbajtur aktivet financiare të Fondit deri në maturim ndryshon, të gjitha aktivet financiare maten me vlerën e drejtë në datën e një ndryshimi të tillë dhe ato nuk mund të maten me koston e amortizuar për të paktën dy vjet nga ajo datë.

Detyrimet financiare maten me koston e amortizuar dhe përfshijnë detyrimet e përfitimeve të pensionit, detyrimet për tërheqje të parakohshme, detyrimet e transferimit të aktiveve dhe tarifave përkatëse, tarifave e administrimit. Tarifave e depozitarit paguhen nga Shoqëria Administruese.

Detyrimet financiare - Çregjistrimi

Fondi çregjistron një detyrim financiar kur kushtet e tij modifikohen dhe flukset monetare të detyrimit të modifikuar janë thelbësisht të ndryshme. Në këtë rast, një detyrim i ri financiar i bazuar në kushtet e modifikuara njihet me vlerën e drejtë. Diferenca midis vlerës kontabël të detyrimit financiar të shlyer dhe detyrimit të ri financiar me kushte të modifikuara njihet në fitim ose humbje.

Nëse modifikimi i një pasivi financiar nuk llogaritet si mosnjohje, atëherë kostoja e amortizuar e detyrimit rillogaritet duke aktualizuar flukset e modifikuara të mjeteve monetare me normën fillestare të interesit efektiv dhe fitimi ose humbja që rezulton njihet në fitim ose humbje të njohur në fitimi ose humbja.

Fshirja

Vlera kontabël bruto e një aktivi financiar fshihet kur Fondi nuk ka pritshmëri të arsyeshme për të rikuperuar një aktiv financiar në tërësinë e tij ose një pjesë të tij. Fondi individualisht bën një vlerësim në lidhje me kohën dhe shumën e fshirjes bazuar në nëse ka një pritshmëri të arsyeshme rikuperimi. Rikuperimet e shumave të fshira më parë përfshihen në 'humbjet nga zhvlerësimi i instrumenteve financiare' në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Megjithatë, aktivet financiare që janë fshirë mund t'i nënshtrohen aktiviteteve përmbartimore në mënyrë që të jenë në përputhje me procedurat e Fondit për rikuperimin e shumave të detyrimeve.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura deri në maturim, të mbajtura me kosto të amortizuar.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje kur ndodhin për shkak të një ose më shumë ngjarjeve ("ngjarjet e humbjes") që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit financiar dhe që kanë një ndikim në shumën ose kohën e flukseve monetare të vlerësuar të ardhshme të aktivitetit financiar ose grupi i aktiveve financiare që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme. Nëse Shoqëria përcakton se nuk ekziston asnjë evidencë objektive që zhvlerësimi ka ndodhur për një aktiv financiar të vlerësuar individualisht, qoftë i rëndësishëm apo jo, ajo e përfshin aktivin në një grup aktivesh financiare me karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë dhe i vlerëson ato kolektivisht për zhvlerësim.

Faktorët kryesorë që Shoqëria merr parasysh në përcaktimin nëse një aktiv financiar është i zhvlerësuar janë statusi i tij i vonuar. Kriteret e tjera kryesore të mëposhtme përdoren gjithashtu për të përcaktuar nëse ka evidencë objektive që ka ndodhur një humbje nga zhvlerësimi:

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

- çdo pjesë ose këst është i vonuar dhe pagesa e vonuar nuk mund t'i atribuohet një vonese të shkaktuar nga sistemet e shlyerjes.
- pala tjetër përjeton një vështirësi të konsiderueshme financiare siç dëshmohet nga informacioni i saj financiar që merr Shoqëria.
- pala tjetër konsideron falimentimin ose një riorganizim financiar.
- ka një ndryshim të pafavorshëm në statusin e pagesës së palës tjetër si rezultat i ndryshimeve në kushtet ekonomike kombëtare ose lokale që ndikojnë në palë.

Letrat me vlerë të borxhit të Fondit përbëhen nga obligacione të Qeverisë Shqiptare. Asnjë ngjarje humbje nuk është identifikuar në datën e raportimit. Vlerësimi kreditor i Qeverisë Shqiptare është përmirësuar nga S&P dhe Moody's në dy vitet e fundit.

2.8. Matjet e vlerës së drejtë

'Vlera e drejtë' është çmimi që do të merrej për të shitur një aktiv ose do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes në principalin ose, në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm për të cilin Fondi ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e një pasivi pasqyron rrezikun e mosperformancës së tij. Kur disponohet, Fondi mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg konsiderohet aktiv nëse transaksionet për aktivin ose detyrimin kryhen me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacion mbi çmimin në vazhdimësi.

Nëse nuk ka çmim të kuotuar në një treg aktiv, atëherë Fondi përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e inputeve përkatëse të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e inputeve të pavëzhgueshme. Teknikat e vlerësimit përcaktohen në rregulloren e përmendur në Shënimin 2.1.

Matjet e vlerës së drejtë për letrat me vlerë të Qeverisë Shqiptare

Bonot e thesarit të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë maten me vlerën e drejtë bazuar në yield-et e ankandeve të fundit të publikuara zyrtarisht nga Banka e Shqipërisë.

Obligacionet e qeverisë shqiptare maten me vlerën e drejtë në bazë të yield-eve të ankandit të fundit dhe periudhës së mbetur deri në maturim. Fondi ka përdorur këto metoda për dhënien e informacioneve shpjeguese të vlerës së drejtë (Shënimi 4). Vlera neto e aktiveve bazohet në koston e amortizuar të aktiveve dhe detyrimeve siç përshkruhet në Shënimin 2.7.

2.9. Mjete monetare

Mjete monetare përfshijnë llogaritë rrjedhëse, depozitat e mbajtura në banka dhe investime të tjera afatshkurtra me likuiditet të lartë me maturime origjinale prej tre muajsh ose më pak nga data e blerjes. Mjetet monetare mbahen me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Depozitat me afat me maturitet origjinal më shumë se tre muaj nga data e blerjes klasifikohen si depozita me afat pranë bankave si një nën-kategori e kredive dhe aktiveve financiare të arkëtueshme.

2.10. Shpenzimet operative

Shpenzimet operative përfshijnë vetëm tarifat e administrimit.

3. Menaxhimi i rrezikut financiar

Aktivitetet e Fondit e ekspozojnë atë ndaj një sërë rreziqesh financiare: rrezikun e tregut (përfshirë rrezikun e monedhës, rrezikun e normës së interesit të vlerës së drejtë, rrezikun e normës së interesit të rrjedhës së parasë dhe rrezikun e çmimit), rrezikun kreditor dhe rrezikun e likuiditetit. Fondi është gjithashtu i ekspozuar ndaj rreziqeve operacionale si rreziku i depozitarit. Rreziku i depozitarit është rreziku i humbjes së letrave me vlerë të mbajtura në kujdestari, i shkaktuar nga falimentimi ose neglizhenca e depozitarit. Megjithëse ekziston një kuadër ligjor i përshtatshëm që eliminon rrezikun e humbjes së vlerës së letrave me vlerë të mbajtura nga depozitari, në rast të dështimit të tij, aftësia e Fondit për të transferuar letra me vlerë mund të dëmtohet përkohësisht.

Fondi i Pensionit Privat "SIGAL PRO"

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur përcaktohet ndryshe)

3. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Programi i përgjithshëm i menaxhimit të rrezikut të Fondit kërkon të maksimizojë kthimet e përftuara për nivelin e rrezikut ndaj të cilit Fondi është i ekspozuar dhe synon të minimizojë efektet e mundshme negative në performancën financiare të Fondit.

Objektivat kryesorë të funksionit të menaxhimit të rrezikut financiar janë vendosja e kufijve të rrezikut dhe më pas sigurimi që ekspozimi ndaj rreziqeve të qëndrojë brenda këtyre kufijve. Funksionet e menaxhimit të rrezikut operacional dhe ligjor synojnë të sigurojnë funksionimin e duhur të politikave dhe procedurave të brendshme, në mënyrë që të minimizohen rreziqet operationale dhe ligjore. Fondi nuk përdor instrumente financiare derivative për të mbrojtur këto ekspozime ndaj rreziqeve.

3.1. Kuadri i menaxhimit të rrezikut

Aktiviteti i Fondit monitorohet dhe menaxhohet nga Shoqëria Administruese. Në përputhje me Ligjin nr.76/2023 "Për fondet e pensionit privat", shoqëria administruese duhet të krijojë një funksion të veçantë kushtuar administrimit të rrezikut.

Kompetencat e Këshillit Administrativ përfshijnë kontrollin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare, zhvillimin e biznesit të shoqërisë administruese; miratimin e politikave financiare dhe investuese; emërimin dhe shkarkimin e administratorëve ose anëtarëve të Komitetit të Investimeve. Këshilli i Administrimit angazhohet të sigurojë që aktet e Shoqërisë Administruese të jenë në përputhje me Ligjin dhe standardet e kontabilitetit. Këshilli Administrativ caktoi anëtarët e **Komitetit të Investimeve**:

- Z. Elvis Ponari, Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë së Administrimit
- Z. Klement Mersini, Drejtues Financiar i "SIGAL Insurance Group SH.A."
- Z. Blodin Çuçi, Administrator i Shërbimeve Këshilluese të Investimeve Caesar
- Z. Naim Hasa, Këshilltar

Komiteti i Investimeve organizon të paktën 4 mbledhje në vit, me qëllim zhvillimin e politikave të investimit, kryerjen e shpërndarjes dhe modifikimit të aktiveve dhe paraqitjen e tyre në shoqërinë administruese. Këto politika mbështeten në analizat cilësore dhe sasiore të tregjeve të kapitalit, tregjeve të riskut dhe analizave të tjera teknike në përputhje me kufizimet dhe limitet maksimale të investimit të përcaktuara me ligj dhe rregulloret e sipërpërmendura.

3.2. Depozitari

Në bazë të Kreut IX nenit 113 të Ligjin nr.76/2023 "Për fondet e pensionit privat", mjetet e fondit të pensioneve, përfshirë mjetet monetare, mbahen pranë një depozitari të vetëm, një bankë e licencuar nga Banka e Shqipërisë, për shërbimet e kujdestarit të miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për rolin e depozitarit. Depozitari i Fondit në datën e raportimit dhe për vitin e përfunduar më pas është Banka Kombëtare Tregtare SH.A. Funksionet e depozitarit përfshijnë llogaritjen e vlerës neto të aktiveve të fondit të pensionit dhe raportimin në baza mujore te Shoqëria Administruese, duke siguruar që të ardhurat nga transaksionet që përfshijnë aktivet e fondit të pensionit të shpërndahen/kapitalizohen te anëtarët e fondeve në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe informimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për çdo çështje që mund të përbëjë shkelje të legjislacionit ose cënim të interesave të anëtarëve. Vlerat e shpalosura në këto pasqyra financiare i nënshtrohen procedurave të plota të konfirmimit dhe rakordimit ndërmjet Shoqërisë Administruese dhe Depozitarit.

3.3. Politika e investimeve

Strategjia e investimit të aktiveve të Fondit të Pensionit Pensionit Sigal Pro bazohet në legjislacionin dhe rregulloret e nxjerra nga AMF, si dhe në politikën e brendshme të investimit të shoqërisë administruese, të propozuar nga Komiteti i Investimeve dhe miratuar nga Këshilli i Administrimit të Shoqërisë Administruese. Shoqërisë Administruese i kërkohet të respektojë rregulloren nr 154 datë 19 shtator 2024 "Mbi rregulla të mëtejshme për investimet dhe veprimtarinë e fondit të pensionit privat".

Fondi i Pensionit Privat "SIGAL PRO"

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur përcaktohet ndryshe)

3. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Kjo rregullore kërkon që fondet të investohen në letra me vlerë që tregtohen në tregje të rregulluara ose bono thesari apo obligacione të Qeverisë Shqiptare, ose titujt e borxhit të bankave dhe institucioneve financiare të mbikëqyrura nga Banka e Shqipërisë. Këto të fundit mund të investohen deri në 5% të aktiveve dhe jo më se 2% në një emetues të vetëm.

3.4. Rreziku i tregut

Rreziqet e tregut lindin nga pozicionet e hapura në (a) monedhat e huaja, (b) aktivet dhe detyrimet me interes dhe (c) instrumentet e kapitalit, të cilat të gjitha janë të ekspozuara ndaj lëvizjeve të përgjithshme dhe specifike të tregut. Drejtimi i Shoqërisë Administruese vendos kufij mbi vlerën e rrezikut që mund të pranohet, i cili monitorohet çdo ditë. Megjithatë, përdorimi i kësaj qasjeje nuk parandalon humbjet jashtë këtyre kufijve në rast të lëvizjeve më të rëndësishme të tregut.

Ndjeshmëritë ndaj rreziqeve të tregut janë paraqitur më poshtë dhe ato bazohen në një ndryshim të një faktori duke i mbajtur të gjithë faktorët e tjerë konstant. Në praktikë kjo nuk ka gjasa të ndodhë dhe ndryshimet në disa nga faktorët mund të lidhen - për shembull, ndryshimet në normat e interesit dhe ndryshimet në normat e valutës së huaj.

3.4.1. Rreziku i valutës së huaj

Fondi gjithashtu mund të kryejë transaksione në monedha vendase dhe të huaja; si rrjedhim lindin ekspozime ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit. Rreziku i monedhës së huaj lind kur vlera e transaksioneve të ardhshme dhe aktiveve dhe detyrimeve monetare të njohura të shprehura në monedha të tjera luhatet për shkak të ndryshimeve në kursin e këmbimit të huaj. Rreziku i monedhës në portofolin e investimit menaxhohet duke përdorur parimet e përputhjes së aktiveve/detyrimeve. Kursi zyrtar i zbatueshëm i këmbimit (leku ndaj njësisë valutore) për monedhat kryesore ishte si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Euro	96.77	98.15

3.4.2. Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit përbëhet nga efektet e rrezikut të luhatjeve në nivelet mbizotëruese të normave të interesit të tregut në pozicionin e tij financiar dhe flukset monetare kohëzgjatja për të cilën norma e interesit është fiksuar në një instrument financiar, prandaj tregon se në çfarë mase është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit. Më 31 dhjetor 2025 dhe 2024, Fondi nuk ka detyrime të rëndësishme me interes dhe për këtë arsye rreziku i normës së interesit lidhet vetëm me aktivet e tij financiare me interes. Çmimet e obligacioneve dhe normat e interesit janë të lidhura në mënyrë të kundërt. Nga ana tjetër, një mjedis me norma të ulëta interesi e bën sfidues për Fondin që të sigurojë një normë të brendshme të përshtatshme kthimi. Një rritje/ulje paralele e kurbës së yield-eve me 1% për portofolin e letrave me vlerë me të ardhura fikse do të rriste/ulte vlerën e drejtë neto të aktiveve të Fondit me 267 mijë lekë (2024: 25 mijë lekë).

Fondi i Pensionit Privat "SIGAL PRO"**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025***(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur përcaktohet ndryshe)***3. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****3.5. Rreziku i likuiditetit**

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit më 31 dhjetor 2024 janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

31 dhjetor 2025	Vlera kontabël	Flukset					
		kontraktuale të paskontuara	Më pak se 1 muaj	Më pak se 3 muaj	3 muaj deri në 1 vit	1 deri në 5 vjet	Më shumë se 5 vjet
Aktive financiare							
Mjetet monetare	4,769,946	4,769,946	4,769,946	-	-	-	-
Investime në letra me vlerë	70,373,919	140,631,945	413,580	1,110,925	2,889,505	22,070,050	114,147,885
Totali i aktiveve financiare	75,143,865	75,143,865	5,183,526	1,110,925	2,889,505	22,070,050	114,147,885
Totali i detyrimeve financiare	(90,763)	(90,763)	(90,763)	-	-	-	-
Hendeku neto i likuiditetit	75,053,102	75,053,102	5,092,763	1,110,925	2,889,505	22,070,050	114,147,885

31 dhjetor 2024	Vlera kontabël	Flukset					
		kontraktuale të paskontuara	Më pak se 1 muaj	Më pak se 3 muaj	3 muaj deri në 1 vit	1 deri në 5 vjet	Më shumë se 5 vjet
Aktive financiare							
Mjetet monetare	414,735	414,735	414,735	-	-	-	-
Investime në letra me vlerë	19,845,930	37,010,207	27,120	621,340	648,460	6,484,537	29,228,750
Totali i aktiveve financiare	20,260,665	37,424,942	441,855	621,340	648,460	6,484,537	29,228,750
Totali i detyrimeve financiare	(21,483)	(21,483)	(21,483)	-	-	-	-
Hendeku neto i likuiditetit	20,239,182	37,403,459	420,372	621,340	648,460	6,484,537	29,228,750

3.6. Rreziku kreditor

Rreziku kreditor është rreziku i humbjes financiare për Fondin nëse një palë e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet e saj kontraktuale. Për qëllime të raportimit të menaxhimit të rrezikut, Fondi merr në konsideratë këto elemente të ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë (si rreziku individual i mospagimit dhe rreziku i sektorit). Këshilli Administrativ ia ka deleguar përgjegjësinë për menaxhimin e rrezikut të kredisë Drejtimit të Shoqërisë Administruese, e cila është përgjegjëse për mbikëqyrjen e rrezikut të kredisë së Fondit. Investimet e Fondit janë në bono thesari dhe obligacione të Qeverisë së Shqipërisë, ndërsa mjetet monetare janë pranë depozitarit.

Vlera kontabël e aktiveve financiare përfaqëson ekspozimin maksimal të kredisë. Ekspozimi maksimal kreditor ndaj rrezikut të kredisë në datën e raportimit ishte si më poshtë:

	Shënimi	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Mjetet monetare	5	4,769,946	414,735
Investime në letra me vlerë	6	70,373,919	19,845,930
Vlera kontabël		75,143,865	20,260,665

Të gjitha mjetet financiare janë korrente dhe nuk janë në vonesë. Nuk është identifikuar asnjë ngjarje humbjeje në datën e raportimit.

Fondi i Pensionit Privat "SIGAL PRO"

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur përcaktohet ndryshe)

3. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Investime në letra me vlerë

Rreziku i kredisë i portofolit të letrave me vlerë të investimeve vlerësohet në bazë të të dhënave historike dhe vlerësimit të aftësisë së Qeverisë Shqiptare për të përmbushur detyrimet e saj kontraktuale të flukseve monetare në periudhën afatshkurtër dhe afatgjatë. Qeveria Shqiptare vlerësohet si BB, e qëndrueshme (përmirësuar nga BB-) bazuar në vlerësimin kreditor të Standard & Poor's dhe Ba3, e qëndrueshme, bazuar në vlerësimin kreditor të Moody's. Nuk ka asnjë tregues humbjeje të identifikuar në datën e raportimit.

Mjete monetare

Mjetet monetare mbahen pranë depozitarit. Depozitari vlerësohet nga JCR si AAA dhe e qëndrueshme. Depozitari rregullohet nga Banka e Shqipërisë e cila monitoron vazhdimisht likuiditetin e bankave të saj të licencuara. Banka e Shqipërisë nuk ka raportuar ndonjë problem likuiditeti.

3.7. Testimi i zhvlerësimit të aktiveve financiare

Përkufizimi i dështimit

Fondi konsideron se një aktiv financiar është në dështim kur:

- pala tjetër nuk ka gjasa të paguajë plotësisht detyrimet e saj kreditore ndaj Fondit, pa masa shtrënguese nga Fondi, siç është realizimi i garancisë (nëse ka); ose
- pala tjetër është e vonuar për më shumë se 90 ditë për çdo detyrim kredie materiale ndaj Fondit.
- në vlerësimin nëse një palë tjetër është në mospagim, Fondi merr parasysh statusin e vonuar dhe mospagesën e një detyrimi tjetër të të njëjtit emetues ndaj palëve të treta.

Inputet në vlerësimin nëse një instrument financiar është në dështim dhe rëndësia e tyre mund të ndryshojnë me kalimin e kohës për të pasqyruar ndryshimet në rrethana. Këto aktive financiare konsiderohen dhe klasifikohen si të zhvlerësuara. Aktivet financiare të Fondit nuk janë as të vonuara dhe as të zhvlerësuara në datën e raportimit.

3.8. Rreziku operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjes direkte ose indirekte që vjen nga një larmi shkaqesh të lidhura me proceset, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën e Fondit, dhe nga faktorë të jashtëm të ndryshëm nga rreziqet e kreditit, të tregut dhe të likuiditetit, si ato që rrjedhin nga kërkesat ligjore dhe rregullatore. dhe standardet e pranuar përgjithësisht të sjelljes së korporatës duke përfshirë reputacionin dhe rrezikun strategjik. Objektivi i Fondit është të menaxhojë rrezikun operacional në mënyrë që të balancojë shmangien e humbjeve financiare nëpërmjet procedurave të kontrollit që kufizojnë iniciativën dhe kreativitetin. Përgjegjësia kryesore për zhvillimin dhe zbatimin e kontrolleve për adresimin e rrezikut operacional i është caktuar Këshillit të Administrimit.

4. Paraqitja me vlerë të drejtë

Paraqitja e vlerës së drejtë të aktiveve financiare të Shoqërisë jepet më poshtë. Vlera neto e aktiveve e bazuar në matjet e vlerës së drejtë është gjithashtu paraqitur më poshtë.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Fondi mat vlerat e drejta duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të vlerës së drejtë që pasqyron rëndësinë e inputeve të përdorura në kryerjen e matjeve shpjegohen në Shënimin 2.8. Tabela e mëposhtme përcakton vlerat e drejta të instrumenteve financiare të cilat nuk maten me vlerën e drejtë, më 31 dhjetor 2025 dhe 2024:

Aktive financiare	Me kosto të amortizuar	Llogaritja e vlerës së drejtë (Shënime 2.8)	Impakti i vlerës së drejtë
31 dhjetor 2025			
Mjetet monetare	4,769,946	4,769,946	-
Investime në letra me vlerë	70,373,919	67,717,793	2,656,126
31 dhjetor 2024			
Mjetet monetare	414,735	414,735	-
Investime në letra me vlerë	19,845,930	20,624,357	778,427

Fondi i Pensionit Privat "SIGAL PRO"

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur përcaktohet ndryshe)

4. Paraqitja me vlerë të drejtë (vazhdim)

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë llogaritë rrjedhëse me bankat rezidente. Duke qenë se këto llogari janë afatshkurtra, vlera e drejtë e tyre konsiderohet shuma e arkëtueshme në datën e raportimit.

Bonot dhe obligacionet e thesarit të Qeverisë Shqiptare

Letrat me vlerë të Qeverisë Shqiptare çmohen me vlerën e drejtë siç përshkruhet në Shënimin 2.8, bazuar në rregullore.

Analiza e ndjeshmërisë

Nëse Fondi do të kishte matur titujt e tij të investimit me vlerën e drejtë, vlera neto e aktivit do të ishte 67,717 mijë lekë më 31 dhjetor 2025 ose 2,656,126 mijë lekë më e ulët se shuma e matur me kosto të amortizuar (2024: 20,624 mijë lekë ose 778 mijë lekë me e ulët sa vlera e llogaritur me kosto të amortizuar).

5. Mjete monetare

Mjetet monetare përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Mjete monetare në bankë në valutë të huaj në Lek	4,769,946	414,735
Totali	4,769,946	414,735

Të gjitha paratë në llogaritë rrjedhëse janë vendosur pranë Depozitarit (Shënimi 1).

6. Investime në letra me vlerë

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Vlera nominale	67,400,000	18,600,000
Primi i akumuluar	2,696,773	1,084,734
Çmimi i blerjes	70,096,773	19,684,734
Amortizimi i vitit i primit	(912,987)	(71,170)
Interesi i përlogaritur	1,190,133	232,366
Totali i kostos së amortizuar	70,373,919	19,845,930

Një listë e letrave me vlerë të investimeve në qarkullim më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024 është dhënë në një shtojcë të këtyre pasqyrave financiare. Siç tregohet në anekset, vlera e drejtë e vlerësuar e letrave me vlerë të investimit në datën e raportimit është më e lartë se vlera kontabël e tyre e cila matet me koston e amortizuar me 2,656 mijë lekë (31 dhjetor 2024: 778 mijë lekë). Referojuni shënimin 4.

7. Detyrimet ndaj Shoqërisë së Administrimit

Tarifa administrative është 1.5% të vlerës neto të aktiveve të Fondit (2024: 1.5%) dhe është e pagueshme te Shoqëria e Administrimit të Fondit (shih Shënimin 1).

Fondi i Pensionit Privat "SIGAL PRO"**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025***(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur përcaktohet ndryshe)***8. Të ardhurat nga interesi**

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Të ardhura nga bonot e thesarit	2,673,915	244,960
Të ardhura nga interesi nga depozitat afatshkurtra	-	5,140
Totali	2,673,915	250,100

9. Shpenzimet e tarifës së administrimit

Për vitin 2025, tarifa totale e administrimit të Fondit arriti në 688,317 Lekë (2024: 89,715 Lekë.). Rritja vjen si pasojë rritjes së kontributeve gjatë gjithë vitit, e cila shfaqet në Vlerën Neto të Aktiveve (NAV) në pasqyrat financiare.

10. Angazhime dhe detyrime të konstatuara**Ligjore**

Fondi nuk është i përfshirë në asnjë padi dhe procedurë ligjore deri më 31 dhjetor 2025.

11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët konsiderohen të lidhura nëse njëra palë ka aftësinë të kontrollojë ose të ushtrojë ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare ose operacionale, ose nëse palët janë nën kontroll të përbashkët me Fondin. Një numër transaksionesh janë lidhur me palët e lidhura në rrjedhën normale të veprimtarisë. Vëllimi i këtyre transaksioneve dhe bilancet e papaguara në fund të periudhave përkatëse janë si më poshtë:

2025	Shoqëria e administrimit	Shoqëria mëmë e shoqërisë së administrimit
Tarifa e administrimit	688,317	-
Kontribute	53,539,169	7,252,000
Tarifë për tërheqje të parakohshme	81,494	

2024	Shoqëria e administrimit	Shoqëria mëmë e shoqërisë së administrimit
Tarifa e administrimit	89,715	-
Kontribute	-	7,252,000

Vlera neto e aktiveve të kontributeve të punonjësve	2025	2024
Tarifa e administrimit		
Sigal Uniq Invest		
- Shpenzimet	688,317	89,715
- Detyrimet	90,763	21,483